



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSIEDNICE

DIVIZIONI PËR MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE
DIVIZIJA ZA UPRAVLJANJE LJUDSKIM RESURSIMA
HUMAN RESOURCES MANAGEMENT DIVISION

Data: 12.05.2025

Udhëheqësja e Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Zyrën së Presidentes së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 48 paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 dhe paragrafit 6 të Ligjit nr. 08/L – 197 për Zyrtarët Publikë, dhe neni 11 paragrafi 2 dhe 3 i të Rregullores (P) nr. 01/2025 për Procesin e Rekrutimit të Sekretares/it të Zyrës së Presidentes/it, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

**PËR ANGAZHIM TË NJË (1) EKSPERTI TË JASHTËM PËR ANËTAR TË KOMISIONIT AD-HOC TË PRANIMIT
PËR SEKRETAR NË ZYRËN E PRESIDENTES/IT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

1. Kandidati që aplikon për ekspert të jashtëm në Komisionin ad-hoc të Pranimiit për Sekretar në Zyrën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

- Diplomë e studimeve universitare, së paku diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor);
- Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese;
- Të mos ketë qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Të ketë integritet moral dhe profesional;
- Të mos ketë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil, si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masa disiplinore në fuqi.

2. Kandidati për ekspert të jashtëm në Komisionin ad-hoc të Pranimiit për Sekretar në Zyrën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional. Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues (bashkëngjitur edhe raportin nga Trusti pensional);
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil, si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

Kandidati i interesuar për ***ekspert të jashtëm për anëtar në Komisionin ad-hoc të Pranimi për Sekretar të Zyrës së Presidentes/it***, dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojë përmes postës elektronike në e-mail adresën: personeli.zprk@president-ksgov.net;

Afati për dorëzimin e CV-së dhe dokumenteve përcjellëse sipas pikave 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit ad-hoc të Pranimi për Sekretar në Zyrën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, është i hapur nga data 12 maj 2025 deri më datë 21 maj 2025.

Për informata shtesë mund të kontaktoni çdo ditë pune deri në orën 16:00, në e-mail adresën: personeli.zprk@president-ksgov.net; dhe në numrin e telefonit: 038 200-511.

Dokumentet e dërguara pas afatit apo të pakompletuara, do të konsiderohen të pavlefshëm.